



Prishtinë: 23.01.2013

Kodi i ZRRE-së: V_500_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_887_12_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_887_12_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 03.01.2013.

Në mbledhjen e mbajtur më 23 janar 2013 nxori këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin H.I (shifra në KEK: DPR - 90043140), nga Fshati Komoran, Drenas, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_887_12_12 i datës 13.12.2012.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për pranimin e instalimit të njehsorit elektrik me datë 16.09.2004 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 202381, dhe gjatë inspektimit kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik nr. 34726109 me gjendje të shpenzimeve: TL=00007 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=00009 kWh (tarifa e ulët).

Konsumatori H.I. me datë 03.09.2006 ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK duke kërkuar nga KEK-u lidhje të re, pra duke kërkuar që t'i regjistrohet njehsori elektrik nr. 12400285.

Me datë 05.09.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 202381, ku kanë konstatuar se objekti i konsumatorit F.I. është i rrënuar mirëpo në të njëjtin oborr konsumatori ka shifrën aktive DPR - 90043140 si dhe kanë rekomanduar bashkim shifrash.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 03.10.2012 përmes urdhër lejimit/ngarkimit numër 43536 ka bartur borxhin nga shifra DPR - 202381 në shifrën DPR 90043140 bazuar në procesverbalin e inspektimit nr. 1739609 i datës 05.09.2012 në vlerë prej 2,158.94€. Pas kësaj ngarkese të bërë nga Departamenti i Faturimit në KEK, konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar këtë ngarkesë. Departamentin për Konsumator në KEK me datë 15.11.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e inspektimit nr. 1739609.

Pas përgjigjes së KEK-ut, konsumatori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 13.12.2012 ka nxjerr vendim duke e



aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që: të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR - 90043140 nga urdhër lejimi/ngarkimi nr. 43536 i datës 03.10.2012 në vlerë 2158.94€, si dhe duke e udhëzuar që borxhin e krijuar në shifrën DPR - 202381 të kërkoj përmes gjykatës kompetente.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së me datë 03.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që konsumatori ka pasur fillimisht pëlqim elektroenergjetik ku ka shfrytëzuar energjinë nga njehsori me shifër DPR – 90043140 në emër të F.I. prindit të H.I. ku pas rrënimit të shtëpisë ka bërë kërkesë për shifër të re. Në ankesë të KEK-ut po ashtu theksohet se komisioni i KEK-ut i cili ka inspektuar pikën matëse të konsumatorit H.I. kanë konstatuar se njëjtën parcelë është ndërtuar një shtëpi e re dhe se në shifrën DPR – 202381 është hapur shifër e re DPR – 90043140 dhe është kërkuar bashkim shifrash. Gjithashtu KEK-u në ankesë ka theksuar se vërtetimi i komunës i datë 09.11.2012 nuk mundet të pranohet nga Bordi si provë valide ngase është shumë i vonshëm dhe nuk paraqet gjendjen faktike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23 janar 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit të KEK-ut, me të cilën pretendohet se DMK gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së konstaton se pretendimet e KEK të theksuara në ankesë nuk tregojnë dhe nuk argumentojnë saktë shkeljet e bëra nga DMK.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe të gjitha procesverbalet e KEK-ut dhe dokumentet tjera të prezantuara nga konsumatori dhe KEK-u, dhe ka vërejtur se procesverbali i KEK-u mbi pranimin teknik i datës 16.09.2004 i bërë në shifrën DPR – 202381 është përpiluar në emër të F.I. dhe punëtorët e KEK-ut kanë bërë pranimin e njehsorit elektrik të ri në atë shifër. Është analizuar edhe kërkesa e konsumatorit H.I. e datës 03.09.2006 për lidhje të re dhe se është vërejtur se KEK-u kësaj kërkesë ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik të konsumatorit duke i hapur shifër të re DPR – 90043140 dhe duke e ngarkuar konsumatorin për shërbime për lidhje të re. Nga kjo datë konsumatori H.I. ka pasur shifrën e vet DPR – 90043140 dhe se është faturuar dhe ka paguar në këtë shifër faturat të energjisë elektrike si konsumator i rregullt.

Gjatë analizimit të proceseve të KEK-ut Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se me rastin e inspektimit të pikës matëse të konsumatorit me shifër DPR – 202381, ku kanë konstatuar se objekti i konsumatorit F.I. është i rrënuar, mirëpo në të njëjtin oborr konsumatori ka shifrën aktive DPR - 90043140 si dhe kanë rekomanduar bashkim shifrash. Sipas raportit të inspektimit të KEK-ut konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar që objekti i mëhershëm është i rrënuar, nuk është i kyçur në rrjetin elektrik përfshi edhe njehsorin elektrik nr. 34726109, por që nuk specifikohet nëse njehsori elektrik është dorëzuar nga konsumatori apo jo.

Është analizuar edhe rrjedha e energjisë aktive e shifrës DPR – 2023801 dhe gjatë analizës është vërejtur se konsumatori nga periudha 08/2002 deri më 08/2004 është ngarkuar me faturim pa matje/paushall nga ana e KEK-ut, ndërsa nga periudha 09/2004 deri më 12/2005 bazuar në shpenzimet reale. Nga transaksionet e konsumatorit të kësaj shifre po ashtu vërehet se nga periudha 01/2006 deri më 09/2012 kur edhe është pasivizuar shifra është ngarkuar vetëm me taksa. KEK-u në asnjë dokument nuk ka dhënë sqarim se pse kjo shifër faturohet pa matje/paushall dhe atë me vlera të ndryshme.



Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut të periudhës 08/2011 deri më 10/2012 dhe ka vërejtur se lexuesi i KEK-ut gjatë leximit të shpenzimeve në shtegun të cilit i përket edhe shifra DPR 202381 ka konstatuar se konsumatori nuk gjendet përkatësisht objekti është i rrënuar.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe Vërtetimin e lëshuar me datë 09.11.2012 numër 06.5.15542 nga Drejtoria për shëndetësi e Mirëqenie Sociale, komuna e Drenasit me të cilën vërtetohet se shtëpia e tij ka qenë e djegur gjatë luftës dhe se informon KEK-un se vërtetimi i Komunës së Drenasit është dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet e Kosovës, dhe se Bordi i ZRRE-së vlerëson se a të pranojë apo jo sprovë atë vërtetim.

Bordi i ZRRE-së konsideron se DMK ka vepruar konform dispozitave ligjore në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit H.I. me shifër DPR – 90043140 me të cilën në pikën e parë ka kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPR - 90043140 nga urdhër lejimi/ngarkimi numër 43536 i datës 03.10.2012 në vlerë 2158.94€, ndërsa në pikën e dytë e ka udhëzuar që borxhin e krijuar në shifrën DPR - 202381 të kërkoj përmes gjykatës kompetente.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirrur në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.01.2013 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_887_12_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar